

**Statut
dhe
Akt Themelimi**

“DEO NDËRTIM” SHPK

08.02.2023



STATUT DHE AKT THEMELIMI i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar

"DEO NDËRTIM"

Sot me date **08.02.2023** në bazë të ligjit nr. 9723 datë 03.05.2007 "Për Q.K.R" të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për shoqëritë tregtare" me vullnetin e lirë themelon shoqërinë "DEO NDËRTIM" SH.P.K.
Me ortak të vetëm z. Naim RRASA që zotëron 100% të kapitalit.

PJESA E PARE DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1 Ortaku Themelues

1.1 Shoqëria është themeluar nga Ortaku i mëposhtëm:

Z. Naim RRASA, me numër personal identifikimi I30504037I, datëlindja 04/05/1983.

Neni 2 Emri i shoqërisë

2.1 Emri i shoqërisë është "DEO NDËRTIM" SHPK (më poshtë referuar si "Shoqëria").

2.2 Emri tregtar i kompanisë është "DEO NDËRTIM" SHPK.

Neni 3 Selia e Shoqërisë

3.1 Selia e Shoqërisë është në adresën: Rruga Marin Beçikemi, Zona kadastrale 8593, numër pasurie 5/392+1-1 (për efekt postar), kod postar 4001, Shkodër.

3.2 Shoqëria mund të hapë degë, përfaqësi, zyra dhe njësi në çdo vend brenda dhe jashtë Shqipërisë dhe do të zbatojë procedurat përkatëse ligjore dhe të regjistrimit. Transferimi i selisë së Shoqërisë në një vend tjetër bëhet me vendimin e Asamblesë së Ortakëve.

3.3 Asambleja e Ortakëve mund të vendosë, hapjen e filialeve, selive dytësore, degëve dhe përfaqësive të Shoqërisë në qytete të tjera të Shqipërisë, dhe jashtë shtetit. Asambleja e Ortakëve mund t'ia delegojë këtë kompetencë organit administrativ.

Neni 4 Forma ligjore

4.1 Shoqëria "DEO NDËRTIM" SHPK e zhvillon veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe dispozita të parashikuara në dokumentet e krijimit të saj (statutit).

4.2 Ky Statut është perpiluar në përputhje me legjislacionin shqiptar që ka karakter të detyrueshëm, ndërsa çështjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në to, plotësohen nga legjislacioni shqiptar.



4.3 Shoqëria “DEO NDËRTIM” SHPK është person juridik.

Neni 5 Kohëzgjatja

5.1 Shoqëria “DEO NDËRTIM” SHPK krijohet për të ushtruar veprimtarinë e saj për një kohëzgjatje **pa afat**.

5.2 Shoqëria “DEO NDËRTIM” SHPK mund të zgjatë afatin e veprimtarisë së saj jo se mund ta mbyllë aktivitetin e saj para këtij afati, sipas dispozitave që përcaktohen në këtë statut dhe sipas kritereve që përcaktohen nga legjislacioni në fuqi.

Neni 6 Objekti i aktivitetit

Shoqëria “DEO NDËRTIM” SHPK do të ketë si objekt:

- Aktivitet në fushën e ndërtimit. Projektim dhe zbatim i veprave ndërtimore si vijon: ndërtime me karakter civil dhe ekonomik, punime/gërmime dhe sistemime dheu, tarracime terrenesh, rikonstruksione godinash civile dhe ekonomike, veshje fasadash, ndertime urash dhe konstruksione metalike, montime panelesh, ndërtime terrenesh, ndërtime rrugësh, asfaltime, hapje kanalesh si dhe çdo ndërtim tjetër me karakter civil dhe ekonomik si hapje kanalizime, ndërtim ujësjellësash, etj.
- Tregtim me shumicë e pakicë të materialeve inerte si beton, asfalto-beton etj. Shtrime rrugësh dhe riparime me beton, asfalto beton ose me materiale të tjera të përdorura për këtë qëllim.
- Ndërtim dhe shtrirje të rrjeteve të gazit natyror, zhvillimi dhe ndërmjetësimi i projekteve për rikonstruksionin e ndërmarjeve industriale, sigurimi i projekteve industriale, ashtu si dhe strukturimi i kontratave afatgjata për lëvrime dhe mbi bazen e këtij aktiviteti rifinancimi dhe kreditimi, ndërmjetësimi.
- Tregtimi me shumicë dhe pakicë i materialeve të ndërtimit import e eksport i tyre brenda dhe jashtë vendit për llogari të vetë shoqërisë si dhe të tretëve ku përfshihen inerte, gurë, gurë dekorativë, gëlqere, pllaka parafabrikate, llaç, çimento, rërë, granile të fraksioneve të ndryshme si dhe çdo material tjetër që nuk është permendur këtu por përdoret për ndërtim. Tregtim me shumicë e pakicë e çdo lloj pajisjeje dhe makinerie që përdoret në fushën e ndërtimit, etj.
- Ndertim rruge, autostrade, mbikalime, hekurudha, metro, tunele. Ndertim ujesjellesa, punime ne diga, hidrocentrale, vepra kullimi e vaditje. Ndertim ura dhe vepra arti, godine civile, industriale dhe turistike. Punime topogjeodezike, punime nentokesore, punime dhe mbrojtje lumore, sistemime hidraulike dhe bonifikime. Restaurime, sherbime hidrosanitare, dhenie me qera e makineri dhe pajisje. Prodhim dhe tregtim i materialeve te ndertimit si asfalt, beton, inerte, materiale parafabrikate dhe prodhime te tjera betoni.
- Import-eksport, agjenci turistike, servis, tregtim karburante dhe vajra lubrifikante.
- Grumbullim dhe transport i mbetjeve inerte.
- Import-eksport fruta perime. Shit-blerje e të gjitha mallrave të lejuara nga legjislacioni vendas e ndërkombëtar.
- Tregtim me shumicë e pakicë artikuj ushqimore dhe industriale, i pijeve freskuese dhe alkoolike, elektroshtëpiake, kinkalери, produkte kozmetike, mobileri, lëndë drusore, dërrasë, rimeso, kompensatë, pllaka zdrukthi, makineri e pajisje, pjesë këmbimi, pajisje elektrike e elektronike, kancelari, pajisje hidrosanitare, detergjentëve, etj.
- Import, eksport, transport për vete dhe të tretë, tregtim me shumicë dhe pakicë, të të gjitha llojeve të mallrave të lejuara nga ligji, për llogari të saj dhe të tretëve.
- Menaxhim i terreneve sportive, bar-restorant, hoteleri, turizëm e agroturizëm.



- Konsulencë financiare dhe juridike, aktivitete ndërmjetësimi, përfaqësimi, përktimi, administrimi, angazhimi dhe promovimi të personave juridikë dhe fizikë të kategorive të ndryshme që shërbejnë në fusha të ngjashme, drejtëpërdrejtë apo me nënkontraktor brenda territorit shqiptar ose jashtë tij.
- Aplikime të çdo natyre në institucione vendase e të huaja.
- Agjenci e shërbime të transportit te pasagjerëve e të mallrave, taksi, shërbime urbane e interurbane, transpedicion si dhe çdo operacion tjetër që bashkohet me veprimtaritë e mësipërme e që konsiderohet i përshtatshëm për rritjen e zhvillimin e mëtejshme të aktivitetit të shoqërisë.
- Projektim, zhvillim, kompletim me pajisje dhe ofrim të instruktazhit për impiante dhe shërbime të ndryshme. Punime ndërtimi.
- Blerje dhe shitje pasuri të paluajtshme, qiradhënia e pasurive të paluajtshme të veta apo si aktivitet ndërmjetësimi për të tretë si Agjenci imobiliare, zhvillim pronash;
- Bar-restorant, beach-bar, hoteleri;
- Shërbime aplikimesh online të lejuara nga legjisllacioni shqiptar; Shërbime aplikimesh në e-albania nga aplikacione të tjera;
- Menaxhimi i pasurive te paluajtshme me pagesë ose kontratë;
- Prodhimi i materialeve inerte dhe shitja e tyre. Shfrytëzimi i kavave nëelumenj e në malc dhe përpunimi i inerteve. Prodhimi i materialeve industriale të ndërtimit si brenda dhe jashtë territorit shqiptar. Përgatitja dhe shpërndarja e llaçit, çimentos dhe konglomerateve bituminoze, përpunimit të lëndës së drurit, hekur betonit e konstruksioneve metalike. Blerja apo marrja me qira e truallit për ndërtimin e fabrikave, linjave dhe impianteve per prodhimin e materialeve të ndërtimit. Vënia në dispozicion e teknologjisë së saj në sektorë të prodhimit dhe në atë të ndërtimit.
- Agjenci funerale, punime mermeri e qeramike, punime varrezash dhe aktivitete të ngjashme.
- Çdo aktivitet mbështetës apo plotësues i pacituar shprehimisht më sipër, por në lidhje me sa më sipër.

Listimi i mësipërm nuk e pengon shoqërinë nga zhvillimi i çdo lloj aktiviteti të lejuar nga ligji me një regjistrim të thjeshtë në organet përkatëse të regjistrimit.

PJESA E DYTË MARRËDHËNIET EKONOMIKE-FINANCIARE

Neni 7 Kapitali themeltar

- Kapitali Themeltar I shoqërisë “DEO NDËRTIM” SHPK është 500 000 lekë i ndarë në 1 pjese. Ky kapital themeltar zotërohet nga ortakut i shoqërisë **z. Naim RRASA** që zotëron 100% të kuotave.
- Kapitali themeltar ose pjesë të caktuara të tij e janë të transferueshme si ndërmjet ortakëve ashtu edhe për kundërt personave të tretë. Transferimi i kapitalit ose pjesëve të tyre në favor të një personi të tretë bëhet gjithmonë me miratim të ortakëve. Nëqoftë se njëri nga ortakët dëshiron të shesë kuotat e kapitalit të tij, duhet të respektojë të drejtën e parablerjes nga ortakët e tjerë, ose aprovimin e tyre unanim për shitjen e pjesës së tij e një subjekti tjetër. Vlerësimi I kapitalit themeltar në natyrë bëhet nga ortakët në një marrëveshje të vecantë ose një nga ekspertët kompetentë I caktuar nga ortakët.
- Zmadhimi ose zvogëlimi I kapitalit themeltar bëhet me vendime të asamblesë së ortakëve. Kapitali themeltar dhe transferimet e tij mbahen në një regjistër të vecantë.
- Shoqëria “DEO NDËRTIM” SHPK për detyrimet që do të lindin gjatë aktivitetit me të tretët, përgjigjet vetëm me pasurinë e saj. Ortakët e shoqërisë nuk përgjigjen për detyrimet e kësaj shoqërie me pasurinë e tyre që nuk është pjesë e kapitalit të shoqërisë. Pjesëmarrja me këtë shoqëri nuk pengon ortakët të kenë pavarësi ligjore, organizative dhe të drejta pronësie jashtë kësaj shoqërie.

- Zvogëlimi i kapitalit përballohet nga secili prej ortakëve në të njëjtën masë me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.

Neni 8

Fitimet e vitit ushtrimor

- Fitimet neto i realizuar nga aktiviteti i shoqërisë do të ndahet ndërmjet ortakëve në proporcion me kuotat e tyre takuese në kapitalin themeltar. Veprimtaria e shoqërisë realizohet në bazë të leverdisë ekonomike dhe pasqyrohet në bilancin e saj. Bilanci I aktivitetit të shoqërisë përgatitet në fund të vitit e duhet të dorëzohet Brenda muajit mars të vitit që vijon.
- Bilanci i aktivitetit financiar mund të bëhet nga vetë ortakët ose nga ekspertët e tyre. Në të gjitha rastet, rezultatet e bilancit financiar duhet t'i bëhen prezente e të aprovohen nga Asambleja e ortakëve brenda 6 muajve të mbylljes së vitit financiar.
- Fitimet që rezultojnë nga bilanci vjetor, u shpërndahen ortakëve në proporcion me pjesët e kapitalit themeltar të zotëruara.
- Asambleja mund të vendosë zbritje të veçanta në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo dhe shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve, plotësisht ose pjesërisht, për vitet financiare të ardhshme.

Neni 9

Rezervat e kapitalit

- Shoqëria krijon fondet e saj për zhvillimin e zgjerimin e aktivitetit.
- Përbërja e fondeve, burimet financiare të tyre, caktohen nga asambleja e ortakëve.
- Shoqëria i disponon plotësisht mjetet e saj financiare.

PJESA E TRETË

TË DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKËVE

Neni 10

Të drejtat e ortakëve

Ortakët kanë të drejta kryesore të cilat ushtrohen nëpërmjet vendimeve të marra nga Asambleja e Ortakëve. Të marrin pjesë në administrimin e veprimtarive ekonomike-tregtare të shoqërisë, nëpërputhje me kontratën dhe statusin.

- Të kërkojnë dhe t'u jepen të dhëna që kanë të bëjnë me gjendjen dhe veprimtarinë e shoqërisë si dhe të gjitha dokumentat e përpunuara nga shoqëria (bilanci, libra-llogarie).
- Të vendosin mb ifitimin/humbjen e viti tushtrimor.
- Të bëjnë propozim edhe t'i paraqesin ato me shkrim para administratorit dhe Asamblesë së Shoqërisë.
- Të heqin dorë nga shoqëria në kushtet që përcaktohen në kontratë dhe në këtë statut.

Neni 11

Detyrimet e ortakëve

Ortakët kanë këto detyra kryesore:



- Të depozitohen kuotën e tyre ose kuotën suplementare në përputhje me kontratën dhe me vendimet e Asamblesë,
- Të marrin pjesë në administrimin e shoqërisë nëpërmjet organeve të krijuara nga ata vetë.
- Të respektojnë detyrimet e caktuara nga Asambleja ose nga Administratori për realizimin e detyrave të shoqërisë.

PJESA E KATËRT

ORGANIZIMI DHE DREJTIMI ADMINISTRATIV I SHOQËRISË

Neni 12

Organet vendimmarrëse – Asambleja e ortakëve

Organi më i lartë vendimor i shoqërisë është Asambleja e Ortakëve.

Në asamble marrin pjesë të gjithë ortakët me të drejtë vote sipas shumave të vëna në kapitalin themeltar të shoqërisë. Asambleja e ortakëve kryen këto funksione:

- Miraton Bilancin vjetor të shoqërisë.
- Vendos për shtimin, pakësimin ose transferimin e kapitalit themelor.
- Emëron dhe revokon Administratorin e shoqërisë.
- Emëron dhe revokon Ekspertin kontabël të Shoqërisë.
- Kryen modifikime në statusin pas ecurive të shoqërisë si dhe kontroll të shoqërisë.
- Vendos për mbylljen e aktivitetit të shoqërisë ose shndërrimin e saj me një tip tjetër shoqërie.

Neni 13

Thirrja e Asamblesë së Ortakëve, Kuorumi dhe Vendimet

- 13.1 Asambleja e Ortakëve thirret të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar për miratimin e bilancit, të raportit të Administratorit/ve, dhe/ose ekspertit kontabël (nëse është emëruar) si dhe të inventarit.
- 13.2 Asambleja mund të thirret në çdo moment prej Administratorit me iniciativën e tij ose sipas kërkesës që do t'i drejtohet Administratorit nga një ose disa prej ortakëve që përfaqësojnë të paktën 5% (pesë përqind) të kapitalit themeltar. Në këtë rast administratori duhet që brenda 10 (dhjetë) ditësh të thërrasë mbledhjen e asamblesë e cila duhet të mbledhet jo më vonë se 35 (tridhjetë e pesë) ditë kalendarike nga datë e kërkesës që i drejtohet Administratorit nga një ose disa prej ortakëve. Asambleja thirret nëpërmjet: a) njoftimit me letër rekomande me kthim përgjigje, b) Faksit; c) Postë elektronike. Njoftimi me postë elektronike konsiderohet i kryer me kalimin e 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga nisja e njoftimit. Njoftimi per secilin ortak dërgohet ne adresat respektive.
- 13.3 Lajmerimi do t'u dërgohet ortakëve, të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara mbledhjes së Asamblesë. Thirrja duhet të përmbajë informacion mbi llojin e Asamblesë, mbi çështjet që do të trajtohen dhe për të cilat do të merret vendim, mbi vendin, orën dhe datën e thirrjes.
- 13.4 Në rast se Asambleja e Ortakëve nuk mbledhet me thirjen e parë për mungesën e kuoromit, Asambleja e Ortakëve do të thirret brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh me të njëjtin rend dite.



- 13.5 Mbledhjet e Asamblesë mund të mbahen edhe nëpërmjet telekonferencës dhe videokonferencës, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen dhe t'u lejohet atyre të ndjekin diskutimin dhe të ndërhyjnë në momentin e trajtimit të çështjeve në rend të ditës; pasi të jenë verifikuar këto kërkesa që duhet të rezultojnë në procesverbalin e mbledhjes.
- 13.6 Asambleja konsiderohet e mbajtur rregullisht nese Asambleja mblidhet ne seline e shoqerise. Asambleja konsiderohet se mbahet rregullisht edhe pa respektimin e formaliteteve të njofimit e të vendmbajtjes në rast se janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë të tërë kapitalin themeltar.
- 13.7 Vendimet e Asamblesë së Ortakëve, për të cilat kërkohet një shumicë e thjeshtë, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 51% (pesëdhjetë e një përqind) të kapitalit themeltar.
- 13.7 Për drejtimin e punëve në çdo Asamble zgjidhet një Kryetar, ortak ose ndonjë person tjetër jo-ortak i caktuar nga vetë Asambleja. Për pasqyrimin e vendimit Asambleja emëron një Sekretar, që mund të jetë edhe jo-ortak.
- 13.8 Vendimet e Asamblesë duhet të nënshkruhen nga Ortakët.

Neni 14 Administratori

- 14.1 Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.
- 14.2 Administratori i shoqërisë përfaqëson shoqërinë në marrëdhënie me të tretët dhe ka të gjitha kompetencat për të vepruar në dhe për llogaritë e shoqërisë.
- Shoqëria merr përsipër të gjitha përgjegjësitë që mund të vijë nga veprimet e kryera nga administratori. Ortaku, sot në themelimin e shoqërisë vendos se: **Administratori** i shoqërisë “**DEO NDËRTIM**” SHPK do të jetë: **z. Naim RRASA**.
- 14.3 Administratori z. **Naim RRASA**, do të emërohet deri 31.01.2028 dhe do mund të riemërohet në fuqi me vendim të posaçëm nga Asambleja e Ortakëve në fund të mandatit, referuar nenit 95 të ligjit 9901 datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.
- 14.4 Administratori mund të emërojë përfaqësues të posaçëm për veprime apo kategori të caktuara veprimesh.
- 14.5 Administratori është përgjegjësi individualisht ose solidarisht ndaj shoqërisë ose ndaj personave të tretë, kur gjatë veprimeve të tyre shkelin ligjin, kontratën dhe statutin, si dhe shkeljet e kryera nga ai gjatë administrimit të shoqërisë. Marrëdhëniet e punës me punëtorët që do të punësohen pranë shoqërisë “**DEO NDËRTIM SHPK**” rregullohen me kontratë individuale, që do të lidhen me secilin prej tyre.
- 14.5 Të dhëna të tjera:

Adresë email: deondertimshpk@gmail.com

Numër telefoni: 0694636555

Neni 15 Viti financiar

- Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të secilit vit.
- Bilancet vjetore, inventari, raportet e Administratorit dhe ekspertit kontabël të autorizuar miratohen nga Asambleja me shumicën e kërkuar nga Ligjit n. 9901 të datës 14.04.2008 “Për tregtarët dhe



Shoqëritë tregtare”.

- Miratimi i dokumentave që lidhen me vitin financiar duhet të bëhet brenda 6 (gjashtë) muajve që nga fundi i vitit financiar.

PJESA E PESTË **MBYLLJA E AKTIVITETIT TË SHOQËRISË**

Neni 16

- Veprimtaria e shoqërisë pushon me mbarimin e afatit të përcaktuar në statut nëqoftëse ortakët me vullnetin e tyre të lire nuk e zgjatin këtë afat.
- Shoqëria mund t'i japë fund aktivitetit të saj dhe para afatit të përcaktuar në aktin e themelimit, me aprovimin e Asamblesë së Ortakëve.

Neni 17

Likuidimi i shoqërisë

- Shoqëria mund të prishet në rastet e parashikuara nga ligji, ose me anë të një vendimi unanim të Asamblesë së Ortakëve. Shoqëria nuk prishet në rast të humbjes së zotësisë për të vepruar, vdekjes, ose falimentimit të ortakëve.
- Kur shoqëria likujdohet plotësisht, Asambleja krijon komisionin e likujdimit në të cilin paraqet bilancin e likujdimit.
- Pasuria e shoqërisë, pasi shlyhen detyrimet e shoqërisë, do të ndahet mes ortakëve në proporcion me kontributin e tyre në kapitalin themeltar.
- Pasuria që është futur në shoqëri me të drejtë shfrytëzimi i kthehet pronarit të vetë saj.

Ky akt është përpiluar me përputhje të plotë me vullnetin e lirë dhe të plotë të nënshkruesve të tij.

ORTAKU I SHOQËRISË **“DEO NDERTIM” SHPK**

Z. Naim RRASA



08.02.2023